

VENDIM
Nr.379, datë 18.5.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I KOPSHTIT DHE
SHKOLLËS FILLORE PUBLIKE, “KALUDH”, KOMUNA PETRAN, PËRMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kopshtit dhe shkollës fillore publike “Kaludh”, komuna Petran, Përmet.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Petran, Përmet.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 300 (treqind) m² tokë/truall, e vlerësuar me 999 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme shpronësimi 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga komuna Petran, Përmet.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë të përballohet nga buxheti i komunës Petran, Përmet.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit qershor 2011.
 7. Komuna Petran, Përmet, të bëjë likuidimin e pronarit brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Komuna Petran, Përmet, si përfituesi për të cilin kryhet procedura e shpronësimit, të kryejë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Përmet.
 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Përmet dhe komuna Petran, Përmet për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha